



VOICE OF ROMA, ASHKALI
AND EGYPTIANS IN KOSOVO

Pranuar më: Primljeno: 01.02-2022		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-610	6214	



ANEKS MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet:

1. Komunës së Lipjanit - përfaqësuar nga z. Imri Ahmeti, kryetar i Komunës;
dhe
2. OJQ "Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve" - përfaqësuar nga z. Isak Skenderi,
drejtor ekzekutiv.

QËLLIMI I ANEKS MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT:

Duke pasur parasysh se palët kontraktuese të lartpërmendura kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me datën 24.02.2020 në Lipjan për: menaxhimin institucional të Qendrave Mësimore që deri më tani janë menaxhuar nga OJQ Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.19/2018 mbi "Themelimin dhe Funkcionalizimin e Qendrave Mësimore nga MASHTI-të.

Duke u bazuar në kërkesën e OJQ Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve për aneks marrëveshje e cila mbështetet në nenin 6 nga marrëveshja ekzistuese, palët pajtohen që të lidhin aneks marrëveshjen e cila do të detajoj bashkëpunimin e mëtejshëm midis dy palëve të lartpërmendura.

ME KËTË, PALËT U PAJTUAN SI NË VIJIM:

1. OJQ "Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve" bazuar në rolet dhe përgjegjësitë e OJQ-së në marrëveshjen e bashkëpunimit rrit pjesëmarrjen e saj financiare për realizimin e 4 qendrave mësimore në komunën e Lipjanit (SHFMU,,Ismael Luma,,Lipjan; SHFMU,,Haradin Bajrami,,Magure; SHFMU,,Fehmi Agani,,Medvec; SHFMU,,Zenel Hajdini,,Gadime) dhe kështu siguron financim për 8 muaj në vitin 2022 duke filluar nga janari 2022. OJQ "Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve" do të siguron shumën prej 21,440 € të cilët do të kontraktojnë drejtpërdrejt pozicionet që punojnë në qendrat mësimore dhe do t'i paguajnë ato drejtpërdrejt nga OJQ-ja. Paratë janë të destinuar vetëm për pagat e personave që do të punojnë drejtpërdrejt në programin e qendrave mësimore;



VOICE OF ROMA, ASHKALI
AND EGYPTIANS IN KOSOVO



2. Komuna për vitin 2022 do të kujdeset të furnizoj qendrat mësimore me material didaktik. DKA për muajt Shtator - dhjetor 2022 do të kryej pageset e pagave të të gjithë tutorëve që punojnë në qendrat mësimore;
3. Komuna s'bashku me OJQ "Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve" do të angazhohet që të siguroj fonde buxhetore për funksionimin e qendrave mësimore për vitin kalendarik 2023
4. Komuna do të raportoj shpenzimet për periudhat e caktuara sipas kërkesës dhe konform nevojës ;
5. Të gjitha kushtet tjera të marrëveshjes bazë mbesin të njëjta.

Ky aneks marrëveshje është përgatitur në gjuhën shqipe, në tri kopje origjinale, dy prej të cilave janë për komunën dhe një për organizatën dhe vlerëshmëria e saj është për periudhën deri më 31.12.2022

Palët nënshkruese:

Komuna e Lipjanit:

Kryetari i komunës,

Imri Ahmeti



OJQ "Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve":

Drejtori ekzekutiv,

Isak Skenderi



Data 01 / 02 / 2022